# DËSHMI ARKIVI

**A-447858**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rrëzohet helikopteri i lajmeve në Los Angeles, 3 të vdekur dhe 2 të plagosur \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/16/rrezohet-helikopteri-i-lajmeve-ne-los-angeles-3-te-vdekur-dhe-2-te-plagosur/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 07:27:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 07:26:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a8c9177f59d2cee0291b6f8c91e4ae6ed84d34758e81b23ed7d22ce69acb8d4e` |
| TEKSTI | `cd48217a085f89844c1f3cf3fee4f128f66d027ee27adac0ba1834578ee4247e` |
| PAMJA | `75acd29e8f7d974940145bb2d9a677014a860658c0c79dbca69139e1d8e4ac0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `949e003f230830b4d2282d37ad841f73b3b5b6cf14af6c8885206f483e0b030c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/949e003f230830b4d2282d37ad841f73b3b5b6cf14af6c8885206f483e0b030c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rrëzohet helikopteri i lajmeve në Los Angeles, 3 të vdekur dhe 2 të plagosur

09:26 : 16/09/2026 në **BOTA**



Tre persona kanë humbur jetën dhe dy të tjerë janë dërguar në spital pasi një helikopter lajmesh u rrëzua të martën në mbrëmje, 15 shtator, në lagjen Chatsworth të Los Angeles.

Helikopteri u rrëzua pak para orës 19:00 me kohën lokale, mes dy ndërtesave tregtare. Autoritetet lokale thanë se ende nuk dihet numri i saktë i personave që ndodheshin në bord dhe emrat e viktimave nuk janë bërë publikë.

Stacioni televiziv NBC Los Angeles konfirmoi se bëhej fjalë për NewsChopper4, helikopterin e përdorur nga stacioni për mbulimin e lajmeve, i cili operonte gjithashtu për Telemundo 52.

Në momentin e aksidentit, helikopteri ndodhej në zonë për të raportuar mbi një aksident të rëndë me autobus.

**Lexo edhe:**

Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes

Zbardhen detajet: Mjekët kërkuan në IA si të shpëtonin këngëtarin grek, Giorgos Mazonakis

Pas rrëzimit, zjarri u përhap në katër automjete dhe dy kontenierë magazinimi. Në operacionin e emergjencës u angazhuan më shumë se 70 zjarrfikës, bëri të ditur Departamenti i Zjarrfikësve të Los Anxhelosit (LAFD).

Kapiteni i LAFD-së, Branden Silverman, tha se një prej viktimave ndodhej jashtë helikopterit në momentin e rrëzimit dhe u shpall i vdekur në vendngjarje.

Gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë në NBC4, gazetarja veterane Colleen Williams konfirmoi se helikopteri i përfshirë në aksident ishte ai i stacionit.

*"E dinim se ishte një helikopter lajmesh. E dinim se kishim humbur kontaktin me njerëzit tanë atje dhe sapo kemi marrë konfirmimin"*, tha Williams.

Disa helikopterë lajmesh ndodheshin në zonën e Chatsworth në momentin e incidentit, pasi po raportonin për një aksident me autobus.

## TË GJITHA


Rrëzohet helikopteri i lajmeve në Los Angeles, 3 të vdekur dhe 2 të plagosur
09:26 : 16/09/2026


Shtrenjtimi i tarifave "zbraz" bankat e shkollave private
09:17 : 16/09/2026


Fituesja e Çmimit Nobel: Duhet ta kufizojmë inteligjencën artificiale, përndryshe njerëzit do humbasin kontrollin
09:12 : 16/09/2026


Tension para Speciales në Hagë/ Policia holandeze përplaset me mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së
08:56 : 16/09/2026


Po Vila nr. 69 në emrin e Dritan Shakohoxhës në Palasë; a do hetohet nga SPAK, nëse është e Blendi Klosit?
08:39 : 16/09/2026


Gjithë sytë e shqiptarëve sot nga Haga, 3 orë nga vendimi për ish-krerët e UÇK-së
08:31 : 16/09/2026


A mund ta bëjë BE-ja Shqipërinë një vend më të aksesueshëm?
08:19 : 16/09/2026

Më herët gjatë së njëjtës ditë, dy persona u vranë dhe gjashtë të tjerë u plagosën pasi një automjet SUV u përplas me një autobus të qytetit në Chatsworth.

Pas aksidentit, autoritetet lokale dhe drejtuesit e shtetit shprehën ngushëllimet për viktimat.

Kryebashkiakja e Los Angeles, Karen Bass, tha se ishte "thellësisht e tronditur" nga humbja e jetëve në Chatsworth.

Edhe guvernatori i Kalifornisë, Gavin Newsom, shprehu ngushëllimet për viktimat dhe familjet e tyre, ndërsa falënderoi ekipet e emergjencës për punën në vendngjarje.

Bordi Kombëtar i Sigurisë së Transportit në SHBA (NTSB) do të drejtojë hetimin për të përcaktuar shkaqet dhe rrethanat e rrëzimit.

Autoritetet nuk kanë bërë ende të ditur se çfarë e shkaktoi aksidentin.

**Etiketa:** helikopter lajme vdekje

**Lajme të lidhura**



**Detaje nga vdekja e Giorgos Mazonakis/ Zbulohen dy foto dhe një video e fshirë nga telefoni i mjekes**

19:04 : 14/09/2026



**Zbardhen detajet: Mjekët kërkuan në IA si të shpëtonin këngëtarin grek, Giorgos Mazonakis**

19:37 : 11/09/2026



**Dy javë pas vdekjes së mbretit Harald V të Norvegjisë, ndërron jetë edhe princesha Astrid**

18:17 : 11/09/2026



**Sporti shqiptar në zi! Ndahet nga jeta Albert Karriqi**

18:04 : 11/09/2026



**"Ku janë kamerat?" Familja e Andi Shalës që humbi jetën në aksident kërkon drejtësi: Pamjet nuk u morën**

21:21 : 10/09/2026



**Shpërthimi në hidrocentralin në Zvicër, humbin jetën dy persona**

18:43 : 09/09/2026


BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

**NA NDIQ**

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.